



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4501/11 Prot.

Tiranë, më 12.07. 2024

URDHËR

NR. 363, DATË 12.07.2024

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “INTELIGJENCË ARTIFICIALE”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT NË TIRANË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Inteligjencë Artificiale”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 72MS0610A.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Inteligjencë Artificiale”, në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Inteligjencë Artificiale”, në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
- Universiteti i New York-ut në Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Universiteti i New York-ut në Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ



Konceptoi:	A. Gjini	<i>[Signature]</i>
Miratuan:	B. Biçoku	<i>[Signature]</i>
	V. Koçi	<i>[Signature]</i>
Konfirmuan:	J. Çollaku	<i>[Signature]</i>
	E. Tola	<i>[Signature]</i>
Data e shkresës tek SP:	__ 4 2024	
Nr. i kopjeve të shkresës:	5	